

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Shtylla III (OMiK) Raporti 08/2005 Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 6 gusht – 21 tetor 2005

Titujt kryesor

- **Kuvendi voton deklaratën e Kryetarit Rugova për “grupin e unitetit” për negociatat**
- **PDK-ja propozon rezolutën për statusin e Kosovës, grupi punues i Kuvendit bën ndryshime, Kryesia përmend “arsye procedurale dhe përmbajtësore” për mosprocedimin e rezolutës**
- **PDK-ja e thërret Kryeministrin Kosumi në interpelancë, Kryeministri Kosumi thotë se nuk do t’i përgjigjet interpelancës që nuk është formuluar si duhet**

1. Sfond

Raporti i dyzetë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej 26 nëntor 2002 dhe bazohet në pajtueshmërinë me Rregulloren e re të punës të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur një seancë të posaçme plenare, më 5 shtator; një seancë të rregullt plenare më 28 dhe 29 shtator dhe 3 e 5 tetor, dhe pesë mbledhje të Kryesisë, më 19 gusht, 14 dhe 20 shtator, 7 dhe 11 tetor. Të gjitha komisionet si dhe nënkomisioni i sapothemeluar për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike i kanë mbajtur mbledhjet gjatë kësaj periudhe.¹ Shtylla e tretë (OSCE) i ka monitoruar të dy seancat plenare dhe të gjitha mbledhjet e Kryesisë, si dhe 56 prej 68 mbledhjeve të komisioneve dhe tre dëgjime publike.²

¹ Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativë, dhe Kornizë Kushtetuese është takuar më 5, 12, 19, 26 shtator, dhe 3, 10, 17, dhe 18 tetor derisa komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim është takuar më 7, 12, 13, dhe 19 shtator, 10, 14, dhe 18 tetor. Komisioni për buxhet dhe financa është takuar më 7, 13, 20, 23 shtator, dhe 13 tetor derisa komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion është takuar më 6, 13, 20, 27 shtator, dhe 11 e 18 tetor. Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media është takuar më 31 gusht, 1, 16, dhe 26 shtator, dhe 5 e 18 tetor derisa komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe personat e zhdukur është takuar më 23 dhe 31 gusht, 8 dhe 15 shtator, 6, 11, 14, dhe 20 tetor. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport është takuar më 25 dhe 31 gusht, 19 shtator, 7, 10, 13, 14, 17, 18, 19 dhe 21 tetor derisa komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike është takuar më 26 gusht, 23 shtator, dhe 3 tetor. Komisioni për gatishmëri emergjente është takuar më 31 gusht, 1, 23, 30 shtator, dhe 13 tetor derisa komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor është takuar më 8, 20, 27 shtator, dhe 7, 12 e 18 tetor. Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike është takuar më 12 dhe 21 shtator. Komisioni për shërbime publike ka mbajtur dy dëgjime publike: Dëgjimin publik të projektligjit për përdorimin e gjuhëve më 8 shtator, dhe Dëgjimin publik të projektligjit për RTK-në më 7 tetor. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport ka mbajtur një Dëgjim publik të projektligjit për trashëgiminë kulturore më 12 shtator.

² Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativë dhe Kornizë Kushtetuese më 5, 12, 19 shtator, dhe 10, 17 e 18 tetor; Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim më 7, 13 shtator, dhe 10, 14 e 18 tetor; Komisioni për buxhet dhe financa më 7, 13, 23 shtator, dhe 13 tetor; Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion më 6, 13, 20, 27 shtator, dhe 11 e 18 tetor; Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media më 31 gusht, 1 dhe 26 shtator, dhe 18 tetor; Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe personat e zhdukur më 23 dhe 31 gusht, 8 dhe 15 shtator, 11 dhe 20 tetor; Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport më 25 dhe 31 gusht, 10, 13, 14, 17, 18, 19 dhe 21 tetor; Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike më 26 gusht, 23 shtator, dhe 3 tetor; Komisioni për gatishmëri emergjente më 31 gusht, 1, 23, 30 shtator, dhe 13 tetor; Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor më 8, 20, 27 shtator, dhe 7, 12 e 18 tetor; Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike më 12

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të 5 shtatorit, e cila është mbajtur në tetë vjetorin e vdekjes së Nënës Terezë, e kryesoi Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci (LDK). Kryetari i Kuvendit Daci; Don Lush Gjergji, prift katolik dhe Kryetar i Shoqatës Nëna Terezë; dhe z. Rexhep Ismajli, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës mbajtën fjalim për nder të Nënës Terezë.

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 28 dhe 29 shtator dhe 3 dhe 5 tetor e kryesoi Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK).

- 80, 79, 82 dhe 92 deputetë ishin të pranishëm më 28 shtator, 29 shtator, 3 tetor, përkatësisht më 5 tetor.³
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 28 - 29 shtatorit dhe të 3 - 5 tetorit 2005:
 - Miratimi i kërkesës së Kryetarit të Kosovës lidhur me përgatitjen për bisedimet për statusin përfundimtar të Kosovës
(Deklarata ishte miratuar me shumicë votash për. Rezultatet e votimit nuk ishin njoftuar.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për sigurimet shëndetësore
(Projektligji ishte shtyrë në mënyrë që Ministria përkatëse dhe komisioni funksional relevant ta diskutojnë më tej një amendament të propozuar me implikime buxhetore.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për duhanin
(Projektligji ishte miratuar me 67 vota për.⁴)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ngrohjen qendrore
(Projektligji ishte miratuar me 58 vota për.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për procedurën e dhënies së koncesioneve
(Projektligji ishte miratuar me 61 vota për.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për kujdesin shëndetësor emergjent
(Projektligji ishte miratuar në parim me 63 vota për.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për veprimtarinë botuese dhe librin
(Projektligji ishte shtyrë.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për edukimin parashkollor
(Projektligji ishte miratuar në parim me 63 vota për.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për gjuetinë
(Projektligji ishte miratuar në parim me 61 vota për.)
 - Shqyrtimi i projektligjit për markat tregtare
(Projektligji ishte miratuar në parim me 79 vota për.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për minierat dhe mineralet
(Projektligji ishte miratuar në parim me 75 vota për.)
 - Shqyrtimi i projektstrategjisë për energjinë në Kosovë 2005-2015
(Projektstrategjia ishte miratuar me shumicë votash për.)
 - Shqyrtimi i raportit të buxhetit të konsoliduar të Kosovës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2005
(Kuvendi e ka diskutuar raportin por nuk e ka votuar atë, meqë raporti i Ministrisë nuk kërkon miratim nga Kuvendi.)
 - Shqyrtimi i kërkesës së grupit parlamentar 6+ për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve
(Kërkesa ishte miratuar me dy vota kundër dhe një abstenim.)

dhe 21 shtator. Dëgjimin publik të projektligjit për përdorimin e gjuhëve më 8 shtator; Dëgjimin publik të projektligjit për RTK-në më 7 tetor; dhe Dëgjimin publik të projektligjit për trashëgiminë kulturore më 12 shtator.

³Këto ishin shifrat e njoftuara nga Kryetari i Kuvendit në fillim të secilës ditë të seancës plenare.

⁴Votat kundër dhe abstenimet nuk ishin njoftuar, përveç nëse në raport është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër. Pasi që janë përdorur pajisjet elektronike për votim, i tërë rezultati i votimit është treguar në ekranin në ballë të sallës plenare, por shifrat nuk mund të shihen nga pjesa e vëzhguesve në fundin e sallës plenare.

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Rendi i ditës

- Rendi i ditës i seancës plenare të 28 dhe 29 shtatorit dhe 3 dhe 5 tetorit nuk ishte paraqitur për miratim në Kuvend, qoftë në fund të seancës së mëparshme apo në fillim të seancës më 28 shtator. Në mënyrë të ngjashme, rendi i ditës për seancën e ardhshme nuk ishte paraqitur për miratim në Kuvend në fund të seancës më 5 tetor.

Kjo është në kundërshtim me rregullën 23.1, e cila kërkon që rendi i ditës për cilëndo seancë plenare të propozohet nga një anëtar i Kryesisë dhe të miratohet nga Kuvendi gjatë seancës së mëparshme. “Në fund të çdo seance, Kryetari i Kuvendit, ose një anëtar tjetër i Kryesisë, propozon rendin e ditës të seancës së ardhshme. Ky propozim konsiderohet i miratuar, përveç në rastet kur një ose më shumë grupe parlamentare ose... gjashtë deputetë e kundërshtojnë këtë.” Siç është përmendur në të gjitha raportet e mëhershme që nga shkurti i vitit 2004 e tutje, caktimi i rendit të ditës është bërë tejet problematik që kur ka filluar Kuvendi të mbajë seancat plenare mujore në shkurt 2004. Në mbledhjet e saj para secilës seancë plenare, Kryesia as që provon të përpilojë rendin e ditës për seancën që vjen pas seancës së radhës, për shkak të paqartësisë në lidhje me atë se cilat pika do të jenë të gatshme për shqyrtim një muaj më vonë. Edhe pse Rregullorja është ndryshuar në mënyrë që të reflektojë miratimin e sistemit mujor të seancave plenare⁵, dispozita që kërkon paraqitjen dhe miratimin e secilit rend dite të seancës plenare në fund të seancës së mëparshme ka mbetur. Nëse nuk është e mundshme për Kryesinë që të propozojë rendin e ditës të seancës plenare një muaj më herët, atëherë Kuvendi duhet ta shqyrtojë mundësinë e ndryshimit të rregullores në pajtim me këtë. Për më tepër, nëse Kryesia nuk është në gjendje ta paraqesë rendin e ditës për miratim në Kuvend në seancën e mëparshme, siç kërkohet me Rregulloren, atëherë Kryesia duhet që – më së paku – ta paraqesë rendin e ditës për miratim në Kuvend në fillim të seancës plenare në fjalë. Rregullorja e parasheh qartë se edhe pse Kryesia e propozon rendin e ditës, në fund të fundit është e drejtë e Kuvendit ta miratojë apo refuzojë rendin e ditës. Sidoqoftë, është bërë praktikë që gjatë seancës plenare të mos ndahet kohë për paraqitjen e rendit të ditës për miratim në Kuvend, qoftë në fund të seancës së mëparshme apo në fillim të seancës në fjalë. Çfarëdo shqyrtimi i rendit të ditës varet nga ajo nëse deputetit i ipet fjala për të propozuar ndryshimin e rendit të ditës para se Kuvendi të vazhdojë me pikën e parë të rendit të ditës. Në shumë raste, Kryetari i Kuvendit ose kryesuesi ka proceduar menjëherë me pikën e parë të rendit të ditës, duke mos i lënë fare mundësi Kuvendit që ta kundërshtojë rendin e propozuar të ditës.

- Në fillim të seancës plenare më 29 shtator, z. Hashim Thaçi (PDK) bëri një deklaratë me të cilën e dënoi mënyrën se si ishte kryesuar seanca plenare gjatë ditës së kaluar (shiko pikën e parë nën “Debatet”). Ai deklaroi se uniteti politik është esencial kur janë në pyetje bisedimet për statusin e ardhshëm të Kosovës dhe se Kuvendi duhej ta miratonte një rezolutë për statusin e Kosovës dhe për procesin e bisedimeve. Z. Thaçi shtoi se rezoluta duhej të miratohej me koncensus, dhe deklaroi se PDK-ja do të ishte e hapur ndaj modifikimeve që mund të propozoheshin nga grupet e tjera parlamentare. Ai e lexoi me zë rezolutën e propozuar, e cila kërkonte që të “rikonfirmohet vullneti i popullit të Kosovës nga të gjitha partitë politike për shtet të pavarur dhe sovran të Kosovës,” qëndrimin e Kuvendit për “mosnegocim për pavarësinë e Kosovës” dhe për “çdo vendim politik nga bisedimet apo marrëveshjet definitive të kenë ratifikimin e Kuvendit të Kosovës apo përmes referendumit nga qytetarët e Kosovës.” Kryetari i Kuvendit deklaroi se nuk kishte asgjë kundër propozimit por rezoluta duhej të shkonte në procedurë të rregullt – duhet të dorëzohet me shkrim në zyrën për parashtresa dhe t’u shpërndahet deputetëve

⁵ Rregulla 22.4: “Seanca e Kuvendit, në kushte të rregullta, mbahet së paku një herë në muaj, brenda një jave plenare. Java plenare fillon, zakonisht, të mërkurën e katërt të muajit dhe përfundon të premten. Kryesia mund t’i shmangët këtij rendi kur e konsideron të nevojshme.” Vëreni se rregullorja lejon që seancat plenare të mbahen më shpesh se një herë në muaj. Përveç seancës plenare të 28 dhe 29 shtatorit dhe 3 dhe 5 tetorit, nuk është mbajtur apo thirrur për t’u mbajtur asnjë seancë në tetor. Seanca e ardhshme është caktuar përkohësisht për mesin e nëntorit. Seancat që mbahen kaq rrallë rezultojnë jo vetëm në ndërlikimin e caktimit të rendit të ditës por edhe në vonesa në miratimin e legjislacionit dhe nismave tjera të rëndësishme të cilat duhet të kalojnë nëpër Kuvend.

për diskutim – duke shtuar se ai kishte të “drejtën kushtetuese” për të përcaktuar nëse një çështje konsiderohet urgjente. Z. Gani Koci (PDK) deklaroi se dëshironte të propozojë se rregullat procedurale ishin shkelur (shiko pikën e parë nën “Mocionet procedurale”). Pas pauzës, z. Thaçi i kërkoi edhe mendimet e grupeve tjera parlamentare në lidhje me rezolutën e propozuar. Përfaqësuesit e grupeve parlamentare e mbështetën përgjithësisht rezolutën por deklaruan se dëshironin ta diskutonin atë vetëm pasi ta kenë marrë me shkrim. Kryetari i Kuvendit filloi me pikën e ardhshme të rendit të ditës, por z. Jakup Krasniqi (PDK) pohoi se e kishte një kërkesë lidhur me rendin e ditës. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se z. Krasniqi po fliste “jashtë kontekstit” dhe se rendi i ditës tashmë ishte miratuar një ditë më parë. Z. Krasniqi deklaroi se PDK-ja konsideronte se pika në fjalë e rendit të ditës nuk ishte përfunduar. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se një pohim i tillë ishte mendim vetëm i z. Krasniqi dhe deputetët e PDK-së e braktisën sallën plenare.

Në vazhdim të seancës plenare më 3 tetor, z. Thaçi edhe njëherë propozoi që rezoluta, e cila tashmë i ishte dorëzuar Kuvendit me shkrim, t'i shtohet rendit të ditës si pikë urgjente. Përfaqësuesit e grupeve tjera parlamentare edhe një herë i dhanë mbështetje të përgjithshme rezolutës por propozuan që të formohej një grup punues për ta shqyrtuar dhe finalizuar tekstin e rezolutës, i cili do t'i paraqitej Kuvendit në një seancë të jashtëzakonshme. U bë një pauzë ashtuqë shefat e grupeve parlamentare të diskutonin se si të vazhdohej më tej. Më pas z. Krasniqi e paraqiti marrëveshjen që ishte arritur: një grup punues i përbërë nga shefat e grupeve parlamentare dhe Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese dhe Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar do ta finalizonin tekstin dhe pastaj do të thirrej një seancë e jashtëzakonshme plenare deri në fund të javës së ardhshme (14 tetor).

Vendimi i Kryetarit të Kuvendit për të mos e vendosur rezolutën e PDK-së si çështje urgjente në rendin e ditës të seancës plenare në zhvillim e sipër ishte në pajtim me rregullën 29 e cila i jep të drejtën Kryetarit të Kuvendit të përcaktojë nëse një çështje “e meriton vëmendjen e menjëhershme të Kuvendit.”

Edhe pse propozimi në lidhje me rendin e ditës në gjysmë të ditës së dytë të seancës plenare do të ishte vërtet i pavend, nuk ishte i saktë pohimi se rendi i ditës tashmë ishte miratuar një ditë më parë. Siç është përmendur në pikën paraprake, Kuvendi nuk ishte ftuar fare që ta miratonte rendin e ditës.

Debatet

- Në seancën plenare të 28 shtatorit, Kryetari i Kuvendit e paraqiti “deklaratën e Kryetarit Rugova lidhur me përgatitjen për bisedimet eventuale për statusin final të Kosovës”, tekst ky që propozonte “ekipin e unitetit”, të udhëhequr nga Kryetari i Kosovës Ibrahim Rugova (LDK), e që do të përbëhej nga Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci (LDK), Kryeministri Bajram Kosumi (AAK), z. Hashim Thaçi (PDK) dhe z. Veton Surroi (ORA), dhe e ftoi Kuvendin ta miratonte atë. Kryetari i Kuvendit deklaroi se ekipi paraqiste një institucion të ri me të cilin do “përmbushen të gjitha kërkesat e popullit të Kosovës, edhe të bashkësisë ndërkombëtare, duke u arritur kështu uniteti funksional, duke u respektuar institucionet e dala nga vota e lirë e popullit, dhe duke u bërë prezantimi i plotë i spektrit politik dhe etnik të Kosovës.” Z. Jakup Krasniqi (PDK) deklaroi në emër të PDK-së se “faktori i unitetit politik i përfaqësuar në Kuvend të bëjë zyrtarizimin e pavarësisë së Kosovës para se të fillojnë bisedimet.” Ai poashtu deklaroi se PDK-ja e vlerësonte nismën e Kryetarit Rugova por për këtë propozim “nuk janë bërë konsultimet e domosdoshme paraprake me partitë relevante, është nënçmuese për spektrin e gjërë politik, qytetar e minoritar,” duke shtuar se përbërja e ekipit duhej “plotësuar me përfaqësues të komuniteteve etnike.” Z. Alush Gashi (LDK) e shprehi mbështetjen e grupit të tij parlamentar për deklaratën dhe deklaroi në emër të LDK-së se të gjitha veprimet e ekipit kombëtar duhet të jenë “konform deklaratës se pavarësisë të vitit 1990 dhe referendumit të vitit 1991 në përputhje me deklaratën e pavarësisë të vitit 1990 dhe të referendumit të vitit 1991” dhe se “Kosova e pavarur me sovranitet bashkekohor do të jete në raporte korrekte me të gjithë fqinjte perreth saj dhe do të jete faktor i stabilitetit.” Znj. Gjylnaze Sylja (AAK) deklaroi mbështetjen e AAK-së për ekipin e propozuar negociator dhe deklaroi se e drejta për vetëvendosje është e garantuar

nga marrëveshja e Rambujesë dhe ishte e panegociueshme, duke shtuar se AAK-ja besonte se qëllimet e rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së ishin përmbushur. Z. Veton Surroi (ORA) deklaroi se procesi negociator tashmë kishte filluar në vitin 1999, pas përfundimit të bombardimit të NATO-s, duke shtuar se dy çështje do të jenë thelbësore për procesin e ardhshëm negociator: niveli i ndërhyrjes nga bashkësia ndërkombëtare pas përcaktimit të statusit të Kosovës dhe niveli i vetëadministrimit të komunitetit serb të Kosovës. Ai konfirmoi se ORA do ta pranonte ftesën e Kryetarit Rugova për të marrë pjesë në negociata. Z. Surroi deklaroi në emër të ORA-s se Kuvendi nuk duhej ta votonte formalisht propozimin e Kryetarit Rugova, sepse votimi i tillë do ta dëmtonte unitetin dhe koncenzusin politik. Z. Mahir Yağcilar (6+/KDTP) deklaroi se komunitetet joserbe duhej të përfshiheshin në negociatë sepse ato ishin “pjesë e pandashme e Kosovës” por ata nuk donin të dukej sikur ata po e pengonin procesin. Kryetari i Kuvendit deklaroi se ai kishte dashur t’i lejonte shëfat e grupeve parlamentare t’i shprehnin mendimet e tyre para se ta ftonte Kuvendin që ta votonte deklaratën. Në atë moment, z. Emrush Xhemajli (LPK) dhe z. Numan Balić (SDA) u afruan te pjesa e përparme e sallës plenare duke kundërshtuar zëshëm faktin se ata nuk ishin lejuar të flisnin. Kryetari i Kuvendit vazhdoi duke thirrur votimin e deklaratës pa marrë parasysh kundërshtimin e zëshëm të shprehur jo vetëm nga z. Xhemajli dhe z. Balić, por edhe nga deputetët tjerë të cilët ishin në vendet e tyre, përfshirë disa deputetë të PDK-së. Shumica votoi për deklaratën. Kryetari i Kuvendit bëri një pauzë pas votimit, dhe kur seanca rifilloi z. Emrush Xhemajli po priste pranë foltores, të cilit së shpejti iu bashkangjiti edhe z. Gjergj Dedaj (PLK). Z. Xhemajli deklaroi se kishte mbështetjen e shtatë deputetëve të Kuvendit – me ç’rast e paraqiti një letër me nënshkrime – prandaj sipas tij duhej t’i lejohej të fliste. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se z. Xhemajli nuk do t’i lejohej të fliste “edhe sikur [ai] ta kishte mbështetjen e 77 deputetëve.” Z. Dedaj deklaroi se “nëse ky parlament është demokratik, edhe partive të vogla duhet t’u lejohet t’i shprehin mendimet e tyre.” Z. Xhemajli pohoi se sipas Rregullores ai kishte të drejtë të fliste dhe vëri në pikëpyetje rëndësinë e ekzistimit të Rregullores së punës nëse ajo nuk zbatohet. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se për sa kohë ai të ishte Kryetar i Kuvendit, deputetët do të flisnin kur t’u ipej fjala. Kryetari i Kuvendit i ndaloi punimet për atë ditë dhe lajmëroi se seanca do të rifillonte mëngjesin e ardhshëm.

Sipas rregullës 12, “deputetët e Kuvendit kanë të drejtë dhe detyrë të barabartë për pjesëmarrje të plotë në punimet e Kuvendit . . . (përfshirë të drejtën) për të marrë pjesë në kushte të barabarta me deputetët e tjerë të Kuvendit në të gjitha diskutimet e Kuvendit.” Rregullorja nuk bën dallim në mes të drejtës për të folur të shëfave të grupeve parlamentare dhe deputetëve të tjerë, dhe poashtu nuk përmban ndonjë dispozitë për kufizim strikt të numrit të pjesëmarrësve në debat. Edhe pse Rregullorja i jep autoritet të konsiderueshëm Kryetarit të Kuvendit në interpretimin e Rregullores gjatë seancës plenare, debati për një çështje kaq të rëndësishme siç është ekipi negociator për statusin e ardhshëm të Kosovës nuk është dashur të kufizohet në një numër kaq të vogël diskutuesish pa një marrëveshje të gjërë në mes të entiteteve politike.⁶

Rregulla 6.5 parasheh se “Kryesia siguron që çfarëdo mocioni përmbajtësor që mbështetet nga gjashtë ose më shumë deputetë të Kuvendit, të futet në rendin e ditës të seancës plenare të Kuvendit brenda tri javësh pune, nga dita kur është marrë kjo shkallë e mbështetjes,” por Rregullorja nuk përmban ndonjë dispozitë që e kushtëzon të drejtën e deputetit për të folur gjatë seancës me numrin e deputetëve që e mbështesin atë.

Shpërndarja e dokumentave

- Projektligji për kujdesin shëndetësor emergjent u është shpërndarë deputetëve të Kuvendit më 22 korrik; projektligji për edukimin parashkollor dhe projektligji për veprimtarinë botuese dhe librin është shpërndarë më 27 korrik; projektligji për gjuetinë është shpërndarë më 3 gusht; Andaj, projektligjet janë shpërndarë 55, 52, përkatësisht 47 ditë pune para shqyrtimit të tyre të

⁶ Duhet vërejtur se Kryetari i Kuvendit ka provuar t’i mbledhë udhëheqësit e partive kryesore shqiptare më 27 shtator, një ditë para se Kuvendi të votonte rezolutën në mënyrë që të krijohet uniteti politik rreth rezolutës, por takimi kishte dështuar sepse shumica e udhëheqësve nuk ishin paraqitur.

parë në seancën plenare më 3 tetor. Projektligji për markat tregtare është shpërndarë më 16 gusht dhe projektligji për minierat dhe mineralet është shpërndarë më 16 gusht; Andaj, projektligjet janë shpërndarë 34, përkatësisht 33 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 5 tetorit.

Caktimi i shqyrtimit të parë të projektligjeve më 3 dhe 5 tetor është në pajtim me rregullën 28.2, e cila kërkon që projektligji t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të paktën dhjetë ditë pune para se të konsiderohet për shqyrtim të parë.

Procesi i votimit

- Kishte kuorum për të gjitha votimet në seancën plenare në fjalë. Pak pas braktisjes së seancës plenare nga PDK-ja më 29 shtator, znj. Fatmire Mulhaxha-Kollçaku (ORA) pyeti nëse kishte kuorum para se ajo të deklarohet për projektligjin në fjalë. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se 61 deputetë ishin të pranishëm. Atë moment, një deputet doli jashtë duke e lënë Kuvendin pa kuorum. Kryetari i ndaloi punimet për atë ditë dhe lajmëroi se Kuvendi do të mbledhë sërish më 3 tetor.

Kjo ishte në pajtim me nenin 9.1.32 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullën 31.1 e cila parasheh që për marrjen e vendimeve të jetë e pranishme shumica e deputetëve. Në rastin e mungesës së kuorumit më 29 shtator, seanca plenare megjithatë ka mundur të vazhdojë me së paku dyzet deputetë të pranishëm, poqese do të kishte kuorum gjatë gjithë votimit.

Interpelanca

- Më 12 shtator, PDK-ja i ka dorëzuar Kryesisë së Kuvendit një interpelancë me nënshkrimet e anëtarëve të saj, me të cilën e thërriste Kryeministrin Kosumi t'u përgjigjet akuzave për korrupsion, posaçërisht lidhur me "kthimin e tij nga Turqia me aeroplan privat." Kryesia, në takimin e saj më 20 shtator, është pajtuar pa diskutim që t'ia dërgojë interpelancën Qeverisë dhe ta vendosë interpelancën në rend dite posa Qeveria të kthej përgjigje. Më 6 tetor, Kryeministri Kosumi i ka dërguar një letër Kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit në të cilën pohonte se formulimi i interpelancës nuk ishte në pajtim me Rregulloren e Kuvendit. "Sipas rregullës 25.3 të Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës, mocioni për interpelancë duhet të përmbajë formulimin e saktë të çështjes që është lëndë e interpelancës . . . Më duhet të shpjegoj se shkresa me të cilën kërkohet interpelancë nuk përmban formulim të qartë të pyetjes për çështje konkrete . . . Ju siguroj se jam i gatshëm që në çdo kohë kur kjo konsiderohet e nevojshme të jap përgjigje për pyetje të formuluar qartë dhe në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit, por jo edhe të përgjigjem në paragjykime, paravlerësime dhe akuza të përfunduara çfarë është "mocioni" i Grupit Parlamentar të PDK-së.

Rregulla 25.3 parasheh, siç është pohuar edhe nga Kryeministri, se një mocion interpelance duhet të përfshijë "formulimin e saktë të çështjes që është lëndë e interpelancës", së bashku me "konkluzionin që propozohet dhe arsyetimin, emrin dhe mbiemrin e deputetit që e ka parashtruar interpelancën në Kuvend, dhe nënshkrimet e deputetëve, që e mbështesin interpelancën." Sipas rregullës 25.4, "Interpelanca i parashtrohet Kryesisë së Kuvendit. Kryesia e Kuvendit, menjëherë sapo ta ketë marrë tekstin e interpelancës, ia dërgon Qeverisë, që është e detyruar ta shqyrtojë brenda jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditësh." Rregulla 25.5 parasheh që "interpelanca vihet në rendin e ditës në afatin prej dhjetë (10) ditësh, pasi të merret përgjigja nga Qeveria . . . Kuvendi nuk mund ta refuzojë vënien e interpelancës për shqyrtim në rendin e ditës, përveç në rast se ajo nuk i plotëson kushtet formale sipas paragrafit 3 të kësaj rregulle."

As Rregullorja e Kuvendit e as Rregullorja e Qeverisë⁷ nuk i lejojnë Qeverisë të ketë rol në përcaktimin nëse interpelanca ishte formuluar në pajtim me rregullën 25.3. Ngjashëm, rregulla 25.4 kërkon nga Kryesia e Kuvendit që ta dërgojë mocionin e interpelancës në Qeveri, pa

⁷ Neni 71 i Rregullores së Qeverisë parasheh se "sa herë që Kuvendi debaton për mocionin e votëbesimit ose mosbesimit të Qeverisë, propozimet për emërim apo shkarkim të ministrave ose interpelancën për punën e Qeverisë, Qeverinë në Kuvend e përfaqëson Kryeministri." Rregullorja e Qeverisë nuk i përmend më tutje interpelancat.

pasur të drejtë që ta bllokojë mocionin bazuar në atë se nuk ishte formuluar si duhet. Vetëm Kuvendi si tërësi mund të marrë një vendim të tillë, siç është përcaktuar në rregullën 25.5. Po kjo rregull kërkon që interpelanca të futet në rendin e ditës të seancës plenare, “në afatin prej dhjetë (10) ditësh, pasi të merret përgjigja nga Qeveria,” pa marrë parasysh përmbajtjen e përgjigjes së Qeverisë. Në të ardhmen, grupet parlamentare kur dorëzojnë interpelanca ndoshta do të duhej të konsultohen me Departamentin për mbështetje ligjore dhe procedurale të Kuvendit, në mënyrë që t’u shmangen rasteve kur mocionet e interpelancës të formuluar jo si duhet procedohen në Kryesi të Kuvendit dhe Qeveri dhe pastaj të refuzohen në seancën plenare të Kuvendit.

Rezoluta për statusin e Kosovës

- Më 11 tetor, Kryesia e Kuvendit është mbledhur për të diskutuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për rezolutën për statusin e Kosovës (shiko pikën e dytë nën “Rendi i ditës”). Kryesia kishte marrë dy raporte, një nga Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe një nga Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese. Të dy raportet i referoheshin verzionit të fundit të rezolutës, të ndryshuar nga grupi punues. Raporti i dorëzuar nga Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar pohonte se komisioni e kishte diskutuar tekstin e rezolutës së propozuar, e kishte miratuar njëzëri dhe i propozonte Kryesisë që ta procedonte atë. Raporti i dorëzuar nga Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese poashtu rekomandonte që Kryesia të procedonte rezolutën urgjentisht por propozoi që të amandamentohej pika e parë e rezolutës së re ashtuqë të propozonte “rekonfirmimin e vullnetit të popullit të Kosovës për shtet të pavarur dhe sovran” në vend të “rekonfirmimit të shpalljes së Kosovës shtet të pavarur dhe sovran.” Anëtarët e Kryesisë shprehën brengosjen që teksti i rezolutës ishte ndryshuar radikalisht nga propozimi origjinal dhe se palët përgjegjëse nuk ishin takuar së bashku dhe nuk ishin pajtuar për një tekst të vetëm por komisionet kishin bërë dy propozime të ndryshme. Kryesia përfundoi se “për arsye procedurale dhe përmbajtësore” rezoluta nuk mund të procedohej tutje në atë moment. Z. Ramë Buja (PDK) e kundërshtoi këtë konkluzion, duke pohuar se shtyerja e pakufizuar e rezolutës ishte thjeshtë një lojë politike.

Mocionet procedurale

- Pas deklarimit të Kryetarit të Kuvendit se rezoluta e PDK-së nuk ishte çështje urgjente (shiko pikën e dytë nën “Rendi i ditës”), z. Gani Koci (PDK) deklaroi se dëshironte të propozonte se rregullorja ishte shkelur. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se z. Koci duhej t’ia dorëzonte me shkrim mocionin zyrës për parashtrësia dhe nuk i lejoi atij të vazhdonte ta parashtronte propozimin gojarisht. Z. Koci u përgjigj se Kryetari i Kuvendit duhet “t’i respektonte rregullat” të cilat i lejonin deputetëve të propozonin mocione të tilla në çdo kohë gjatë seancës plenare. Z. Jakup Krasniqi propozoi të bëhej një pushim i shkurtë, sepse PDK-ja ishte e pakënaqur me mënyrën se si ishte trajtuar kërkesa e tyre, dhe Kryetari i Kuvendit u pajtua që të bënte një pushim.

Rregulla 30.1 parasheh që “në çdo seancë plenare të Kuvendit deputetit i jepet e drejta t’i propozojë këto mocione procedurale . . . [përfshirë edhe mocionin mbi] konstatimin se a është shkelur Rregullorja e punës.” Rregulla 30.5 më tej parasheh që “në rastet kur bëhet një mocion për të konstatuar se a është shkelur Rregullorja e punës, Kryetari i Kuvendit do të vendosë menjëherë ose kur është e nevojshme pas shqyrtimit të mëtejshëm nëse mocioni është i rregullt. Në raste të tilla Kryetari udhëzon shkelësin e Rregullores së punës ta respektojë atë.” Rregulla 30.8 parasheh që “mocionin për të konstatuar zbatimin e Rregullores së punës dhe mocionin për shkeljen e të drejtave të deputetit, mund t’i bëjë, madje, vetëm një deputet. Ky mocion i parashtrohet Komisionit për çështje gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, që në seancën e parë plenare të Kuvendit duhet ta paraqesë rekomandimin e tij lidhur me mocionin.” Sipas rregullës 30.1 është e qartë se z. Koci kishte të drejtë gjatë seancës të propozonte mocion për të konstatuar se a ishte shkelur Rregullorja. Kjo çështje megjithatë komplikohet pak nga

rregulla 2, që i definojnë mocionet si propozime të shkruara.⁸ Nëse një deputet i Kuvendit dëshiron gjatë një seance plenare ta sfidojë zbatimin e Rregullores së punës, në pajtim me Rregulloren, atij ose asaj duhet t'i mundësohet që ta ngris çështjen me kërkesën e tij/saj, në vend se të udhëzohet që të dorëzojë mocionin me shkrim në zyrën për parashtrësia. Rregullorja nuk përmban ndonjë procedurë të veçantë në rastet kur Kryetari i Kuvendit (ose Kryesuesi i seancës plenare) akuzohet për shkelje të Rregullores, por në vend të kësaj ai ka të drejtë, sipas rregullës 30.5, të përcaktojë nëse veprimet e tij ishin në pajtim me Rregulloren. Nëse deputeti i Kuvendit, i cili ka sfiduar zbatimin e Rregullores, është i pakënaqur me vendimin, ai apo ajo sipas rregullës 30.8 mund t'i dorëzojë mocion me shkrim Komisionit për çështje gjyqësore, legislative dhe Kornizë Kushtetuese. Megjithatë, Rregullorja nuk e qartëson raportin në mes të vendimeve të marra nga Kryetari i Kuvendit gjatë seancës plenare dhe vendimeve të marra nga Komisioni: nuk është e qartë nëse një vendim ka përparësi ndaj tjetrit. Kuvendi ndoshta do të mund të mendonte për amandamentimin e rregullës 30 ose të lëshojë udhëzime plotësuese në mënyrë që të qartësohet më mirë procedura për sfidimin e zbatimit të Rregullores.

- Më 24 gusht, grupi parlamentar ORA i dorëzoi Kryesisë një mocion në të cilin pohonte se mënyra se si seanca plenare e planifikuar për 26 gusht ishte anuluar përmes një e-maili nga administrata e Kuvendit duke cituar “për shkaqe teknike”, përbënte shkelje procedurale. ORA pohonte se seancat plenare për të cilat ishte pajtuar Kryesia e Kuvendit mund të anuloheshin vetëm nga Kryesia në konsultim me shefat e grupeve parlamentare. Kryesia, në takimin e saj më 20 shtator, ishte pajtuar pa diskutim që t’ia dërgonte mocionin Komisionit për çështje gjyqësore, legislative dhe Kornizë Kushtetuese. Komisioni e ka diskutuar mocionin më 10 tetor, me ç’rast anëtarët konstatuan se rregullat për caktimin e rendit të ditës dhe konsultimin me grupet parlamentare nuk respektoheshin gjithmonë. Komisioni konstatoi se mocioni i ORA-s ishte i bazuar dhe se “rregullorja duhet të respektohet.”

Sipas rregullës 30.8, “Mocionin për të konstatuar zbatimin e Rregullores së punës dhe mocionin për shkeljen e të drejtave të deputetit, mund t’i bëjë, madje, vetëm një deputet. Ky mocion i parashtrëhet Komisionit për çështje gjyqësore, legislative dhe Kornizë Kushtetuese, që në seancën e parë plenare të Kuvendit duhet ta paraqesë rekomandimin e tij lidhur me mocionin.” Andaj, komisioni duhet ta deklarojë rekomandimin e tij në seancën plenare të radhës në nëntor.

4. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve

- Më 2 shtator, z. Mahir Yağcılar (6+/KDTP) i dorëzoi Kryesisë së Kuvendit një kërkesë për hapjen e versionit në turqisht të ueb faqes së Kuvendit të Kosovës, “bazuar në parimet e përdorimit të barabartë të gjuhëve për dokumentet e Kuvendit të Kosovës.” Z. Yağcılar kishte deklaruar në kërkesën e tij se për hapjen ueb faqes së tillë do të ishte e nevojshme që të angazhohej një përkthyes turk dhe një lektor. Z. Gazmend Muhaxheri deklaroi se versioni në turqisht i ueb faqes së Kuvendit do të ishte një hap pozitiv drejt përmbushjes së Standardeve. Kryetari i Kuvendit deklaroi se nuk kishte asgjë kundër propozimit, por do të ishte më mirë të pritej derisa të miratohej projektligji për përdorimin e gjuhëve.
- Në mbledhjen e Kryesisë më 20 shtator, z. Džezair Murati (6+/Vakat) deklaroi se pa dashur ta politizonte çështjen e ekipit negociator për statusin, ai dëshironte ta paraqiste qëndrimin e grupit parlamentar 6+ se delegacioni ishte “i pakompletuar” dhe duhej të përfshihej së paku një anëtar i “të ashtuquajturëve komuniteteve të integruara minoritare”. Ai shtoi se përfshirja e përfaqësuesit të komunitetit minoritar do të shkonte në dobi të ekipit negociator sepse do të demonstronte se edhe komunitetet tjera ndajnë të njëjtin qëndrim me shqiptarët e Kosovës për statusin e Kosovës. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se ai nuk kishte qëllim të mos pajtohej me z.

⁸ Nga rregulla 2, e cila i definojnë termet e përdorura në Rregullore: “**Mocion** do të thotë: (a) një propozim përmbajtësor i shkruar e i dorëzuar në Zyrën për Propozime dhe Parashtrësia; ose (b) një propozim procedural, i shkruar që i paraqitet Kuvendit për shqyrtim dhe votim në pajtim me këtë Rregullore.”

Murati, por përbërja e ekipit ishte propozuar përmes deklaratës së Kryetarit të Kosovës. Kryetari i Kuvendit propozoi që komunitetet minoritare do të mund të përfaqësohen në grupet punuese.

Nuk është ndërmarrë asgjë konkrete, siç do të mund të ishte rekomandimi i Kuvendit për ekipin negociator, përkundër deklaratës së PDK-së se përbërja e ekipit duhej të “plotësohej me përfaqësues të komuniteteve etnike” dhe pohimit të Kryetarit të Kuvendit se ekipi paraqiste institucion të ri që “plotësisht do të përfaqësonte spektrin politik dhe etnik të Kosovës”, të dyja këto deklaratë të bëra gjatë debatit të shkurtër mbi deklaratën e Kryetarit Rugova (shiko “Debatet”).

5. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancën plenare dhe në mbledhjet e Kryesisë dhe të komisioneve. Shtylla e III-të (OSBE) gjithashtu ka pranuar kopjet e të gjitha dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

6. Transparenca

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetim të drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web faqen (www.kuvendikosoves.org, www.skupstinakosova.org, www.assemblyofkosovo.org). që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera.

FUND.